

UDHËZIM
Nr. 25, datë 28.12.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, “PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre” dhe vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, i ndryshuar bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” dhe akronimi “MASR” të zëvendësohen përkatësisht me “Ministria e Arsimit dhe Sportit” dhe “MAS”.

b) Pika 1 e kreut I/A.1 ndryshon si vijon:

“1. Pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, ministria përgjegjëse për arsimin procedon me miratimin e statutit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me miratimin e statutit të institucionit të arsimit të lartë me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit, krijimit të organeve kolegjiale dhe emërimit/zgjedhjes së autoriteteve drejtuese, IAL-ja aplikon në platformën e-Albania për hapjen e programeve të studimit sipas procedurave në kreun IV, të këtij udhëzimi. Pas miratimit të statutit dhe të programeve të studimit, MAS-i kryen verifikimet në terren për përmbushjen e standardeve dhe të kriterëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”.

b) Pika 6 e kreut II/A ndryshon si vijon:

“b. Në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit dhe dokumentacionit, ministri miraton me urdhër hapjen e degës si njësi kryesore/bazë e IAL-së dhe dega brenda 30 ditëve nga data e miratimit aplikon në platformën e-Albania për hapjen e programeve të studimit, në funksion të degës si njësi kryesore/bazë të miratuar.”.

c) Germa “e” e pikës 5 të kreut III/A ndryshon si vijon:

“e) Listën e programeve të studimit dhe planet mësimore që do të mbulohen/mbështeten nga njësia kryesore e re/riorganizuar, listuar sipas njërive bazë përgjegjëse për realizimin e tyre.”.

d) Germa “b” e pikës 6 të kreut III/A ndryshon si vijon:

“b) Në rast të vlerësimit pozitiv të aplikimit dhe dokumentacionit, ministri miraton me urdhër hapjen/riorganizimin e njësisë kryesore dhe IAL-së brenda 30 ditëve aplikon për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit në funksion të njësisë kryesore të miratuar, në platformën e-Albania.”.

e) Nënpara "v" e gërës "e" të pikës 3 të kreut IV/A, shfuqizohet.

f) Në fund të gërës "c" të shtojcës nr. 2 të udhëzimit "Plani mësimor/kurrikula e programit të studimit", shtohet fjalia si vijon:

"Në rast të aplikimit për riorganizimin e programit të studimit, duhet pasqyra analitike e kurrikulës mësimore ekzistuese, si dhe e kurrikulës mësimore për programin e studimit që aplikohet për riorganizim."

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Evis Kushi